

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Pejë, me trupin gjykues të përbërë nga gjykatësi Malkolm Simons (Malcolm Simmons) si gjyqtar kryesues dhe gjyqtarët Riku Jaakkola dhe Shaban Shala, si anëtarë të kolegjit dhe të procesverbal mbajtëses Robina Stradhers (Robina Stradhers) në çështjen penale kundër Arsim Gashit, Mirsat Ibrahimit dhe Halim Krasniqit (në tekstin e mëtejshëm "të pandehurit"), të akuzuar në bazë të Aktakuzës PP. numër 73/2001 të datës 5 korrik 2001, të ndryshuar dhe plotësuar me gojë nga ana e prokurorit më 15 janar 2002 dhe 11 nëntor 2010 me veprën penale *Posedim i paligjshëm i një sasi të madhe të armëve* në kundërshtim me nenin 199 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, pas mbajtjes së gjykimit publik më 3 dhe 11 nëntor 2010 në cilin z. Peter Kornek (Peter Korneck) u paraqit në emër të Prokurorisë kurse z. Besnik Berisha u paraqit si avokat mbrojtës për të pandehurit Arsim Gashi, Mirsat Ibrahimit dhe Halim Krasniqi të cilët ishin gjithashtu të pranishëm, më 11 nëntor 2010 mori dhe publikisht shpalli këtë

AKTGJYKIM

I pandehuri Arsim Gashi, numri i ID 100986578, i lindur më 27 nëntor 1977 në Pejë, emri i babait Shaban, emri i nënës Halime Kelmendi, shqiptar i Kosovës, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, din shkrim e lexim, student, në paraburgim prej 10 Maj 2001 deri më 6 mars 2002;

I pandehuri Mirsat Ibrahim, numrin e identifikimit 1009455201, i lindur më 15 maj 1962 në Pejë, emri i babait Isuf, emri i nënës Pesen Kelmendi, shqiptar i Kosovës, me banim në Pejë, i gjendjes së varfër ekonomike, din shkrim e lexim, i papunë, i martuar, baba i 3 fëmijëve, në paraburgim prej 10 majit 2001 deri më 19 dhjetor 2001 dhe

I pandehuri Halim Krasniqi, numrin e identifikimit 1004986767, i lindur më 20 prill 1971 në fshatin Drenoc, komuna e Malishevës, emri i babait Avdyl, emri i nënës Fahrie Paqarizi, shqiptar i Kosovës, i martuar, baba i 2 fëmijëve, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, din shkrim lexim, në paraburgim prej 10 majit 2001 deri më 10 nëntor 2001, janë

FAJTORE

Sepse më 10 maj 2001, në vende të ndryshme, të përmendurit Arsim Gashi, Mirsat Ibrahimit dhe Halim Krasniqi u vunë re nga pjesëtarë të karabinierëve italianë, si pjesë e një grupi të organizuar që ranë në kontakt me shoferin e një kamioni MAN me numër

regjistrimi 816 M 690 dhe me numrin e regjistrimit të rimorkios 719 M 226 në një zonë parkimi përballë doganës në Pejë. Pas kësaj, të përmendurit Arsim Gashi dhe Mirsat Ibrahimimi drejtuan një automjet BMW 325 me numër të regjistrimit 124 KS 552 para kamionit kurse Halim Krasniqi së bashku me një tjetër individ drejtonin një automjet të zi Mercedes 250m me numër të regjistrimit 128 KS 533, prapa kamionit, si pjesë e një konvoji që po e shoqëronte kamionin në drejtim të një banesë private në Pejë. Ata janë ndjekur dhe arrestuar më pas nga karabinierët para një shtëpie private në Pejë. Gjatë kontrollit të kamionit në fjalë, policët zbuluan një sasi të madhe të armëve në mesin e të cilave ishin: 52 raketa-hedhës anti tanke të prodhimit ish-jugosllav të kalibrit mod. 44 mm. "M-80" ; 20 cilindra kartoni të zi që përmbanin bomba mortaje të prodhimit ish-jugosllav të kal. mm 81/82 mod. "M-69" me siguresa të rregullueshme për veprim të menjëhershëm apo të vonuar; 4 cilindra kartoni të zi që përmbanin bomba mortare të prodhimit ish-jugosllav të kal. mm 81/82 mod. "M-74" me siguresat rregullueshme për veprim të menjëhershëm apo të vonuar; 1 cilindër kartoni të zi që përmbante bomba mortaje të prodhimit ish-jugosllav të kal. mm 81/82 mod me siguresa të rregullueshme në Bakelite për veprim të menjëhershëm pa numër serik; 1 top i tipit ish-jugosllav pa predhë të zmpasjes e kal. mm. 81/82 mod. "M-61", 10 cilindra kartoni të zi që përmbanin predha topi të prodhimit ish jugosllav mm. 82 mod. "M-60A"; 2 kutija të gjelbërta që përmbanin 1 raketë anti-tank që udhëhiqet me tel e modelit "AT-3 Sagger" secila pa konzole kontrolli , 12 hedhësa raketa anti-tank mod. "M-79" e kalibrit 90 mm. prej tyre numri i 10 i plotë, Numri 1 pa pajisje shkrepjeje dhe vështrimi dhe Numri 1 pa mbështetje për shpatull si dhe pa pajisje shkrepjeje dhe vështrimi, 12 hedhëse raketash anti-tanke mod. "M-79" të kalibrit 90; një mortajë e mod. "M-57" e kalibrit 60 mm. pa pjatë mbështetjeje; 1 pajisje për shikim për mortajën modeli "M-57" e kalibrit 60 mm; 1 mortajë e modelit "M-69" e kalibrit 81/82 mm. pa dykëmbësh, e pajisur me shtupë për pastrim; 1 top pa zbrapsje e modelit "M-60A" e kalibrit 82 mm. E hipur hipur mbi një shtrat topi me rrota me shtupë për pastrimin dhe pa pajisje vështrimi; 4 raketa anti-ajrore portative të modelit "SA-14" të kalibrit 7 mm, nga ato numri 1 me pajisje të shkrepjes; 7 bateri të cilat mund të ghuhen për raketa anti-ajrore portative të modelit "SA-14" të kalibrit 75 mm. pa numër serik; 1 pajisje shkrepjeje për raketa anti-ajrore portative të modelit "SA-14" të kalibrit 75 mm; 1 portativ raketa anti-ajrore portative e modelit "SA-16" e kalibrit 70 mm., pa pajisje shkrepjeje dhe bateri; 2 mitraljoza të modelit Zastava "M-84" të kalibrit 7,62 mm; 1 kuti e cila përmbante një rrip arme me 98 predha, për modelin Zastava "M-84" të kalibrit 7,62 mm.; 1 pushkë sulmi Zastava e modelit "M70-A" e kalibrit 7,63 x 39 mm, 4 magazina për pushkë sulmi të modelit Zastava "M70-A" të kalibrit 7,63 x 3 mm; 86 predha të ndryshme (predha gjurmëlënëse, plumba të zakonshëm dhe shtypës) për pushkë sulmi të modelit Zastava "M70-A" të kalibrit 7,63 x 39 mm; 5 pushkë gjysëm automatike të modelit Zastava "M76-A" të kalibrit 7.9 mm.me pajisje vështrimi të saktë dhe magazina; 20 predha të kalibrit 7,9 mm për pushkë gjysëm automatike "M76-A". Gjykata konstaton se në çdo kohë të pandehurit Arsim Gashi, Mirsat Ibrahimimi dhe Halim Krasniqi ishin në zotërim të armëve te cekura.

Prandaj, të pandehurit Arsim Gashi, Mirsat Ibrahimimi dhe Halim Krasniqi, në bashkëpunim, kanë kryer veprën penale të posedimit të paligjshëm të një sasive të madhe të armëve në bazë të nenit 199 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në bashkim me nenin 22 i Kodit Penal të Republikës Socialiste

Federative të Jugosllavisë.

Dhe janë dënuar për veprat në fjalë si vijon:

Arsim Gashi dënohet me burgim prej 300 ditësh.

Mirsat Ibrahimimi dënohet me burgim prej 223 ditësh.

Halim Krasniqi dënohet me burgim prej 185 ditësh.

Në bazë të nenit 50 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe të nenit 351 të Ligjit të Procedurës Penale, do të llogaritet koha të cilën tashmë e kanë kaluar në paraburgim.

Gjykata nuk lëshon vendim për shpenzimet.

Aktgjykimi i formës së prerë mund të shpallet në media publike.

Gjykata do të lëshojë aktgjykimin me shkrim brenda 15 ditësh.

Palët kanë të drejtë të apelojnë këtë aktgjykim.

Të pandehurit janë të obliguar ta lajmërojnë në gjykatën për çdo ndryshim të adresës derisa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

ARSYETIM

A. Rrethanat procedurale

Aktakuza u ngrit më 5 korrik 2001 në Gjykatën e Qarkut në Pejë kundër Hakif Hamitit, Arsim Gashit, Mirsat Ibrahimit, Halim Krasniqit, Agron Hamitit, Gjezair Miftarit dhe Xheladin Gashit.

Aktakuza përmbante tri baza:

- *Posedim të paligjshëm të një sasive të madhe të armëve* në kundërshtim me nenin 199 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në bashkim me nenet 8 dhe 19 të Ligjit mbi blerjen, posedimin, dhe mbajtjen e armëve dhe të municioneve (Ligji No . 40 i 1980) dhe nenit 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë për të pandehurit Hakif Hamiti, Arsim Gashi, Mirsat Ibrahimimi, Halim Krasniqi, Agron Hamiti, Xhezair Miftari dhe Xheladin Gashi.

- *Legalizimi i përmbajtjeve të pavërteta në dokumentet zyrtare* në kundërshtim me nenin

205 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në bashkim me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë për të pandehurit Hakif Hamiti, Arsim Gashi, Mirsat Ibrahim, Halim Kreansiqi, Agron Hamiti, Xhezair Miftari dhe Xheladin Gashi.

- *Posedim të paligjshëm të armëve* në kundërshtim me nenin 197 paragrafi 1 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në bashkim me nenin 2 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë për të pandehurit Xhezair Miftari, Xheladin Gashi dhe Halim Krasniqi.

Gjykimi i parë kryesor ka filluar më 19 dhjetor 2001 para një trupi gjykues ndërkombëtar dhe ka përfunduar më 6 mars 2002. Në aktgjykimin e vet, trupi gjykues vendosi ta lirojë Agron Hamitin nga të gjitha akuzat. Ai më tej ka vendosur që të pandehurit Arsim Gashi, Mirsad Ibrahim, Halim Krasniqi dhe Xheladin Gashi të shpallen fajtorë për *posedim të paligjshëm të një sasive të madhe armësh*, në kundërshtim me nenin 22 të LPJ dhe nenin 199 paragrafi 1 dhe 3 të LPK-së, por i liroi ata nga akuza e *legalizimit të përmbajtjeve të pavërteta në dokumentet zyrtare në bashkëpunim*, në kundërshtim me nenin 205 të LPK-së në bashkim me nenin 22 të LPJ-së dhe nga vepra penale e *organizimit të një grupi, në bashkëpunim*, për kryerjen e veprës penale të *posedimit të paligjshëm të armëve* nga neni 197 paragrafi 1 të LPK-së në bashkim me nenin 22 të LPJ-së, meqë elementët e veprës penale ishin konsumuar nën pikën një.

Trupi gjykues kishte vendosur më parë që procedura kundër Xhezair Miftarit dhe Hakif Hamitit të jetë e ndarë nga të pandehurit e tjerë për shkak të gjendjes së tyre mjekësore.

Gjykata Supreme në një vendim të datës 6 mars 2005 vendosi ta anulojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e dërgoi çështjen për rigjykim.

Në dhjetor të vitit 2009, kryetari i Gjykatës së Qarkut në Pejë i ka kërkuar presidentit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it që gjyqtarët e EULEX-it të marrin përsipër këtë rast për shkak të pengesave procedurale. Rasti i ishte dorëzuar gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Pejë më 24 shkurt 2010. Rasti filloi më 3 nëntor 2010 dhe përfundoi më 11 nëntor 2010.

B. Gjykimi i dytë kryesor

Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në publik më 3 dhe 11 nëntor 2010 në praninë e të akuzuarve Arsim Gashi, Mirsat Ibrahim, Xheladin Gashi dhe Halim Krasniqi. Ky rast u hap zyrtarisht më 11 nëntor 2010. Para hapjes së çështjes, prokurori publik e ndryshoi aktakuzën e 5 korrikut 2001 duke proceduar në bazë 1 vetëm. Për më tepër, prokurori publik e tërhoqi aktakuzën kundër pandehurit Xheladin Gashi, sepse ky i pandehur ishte në të gjitha momentet relevante në spital.

Palët nuk patën vërejtje sa i përket juridiksionit të gjykatës apo përbërjes së trupit gjykues.

Të tre të pandehurit të gjithë u deklaruan fajtorë për veprën penale të posedimit të një sasive të madhe të armëve, pas konsultimit me avokatin e tyre mbrojtës.

Përkthyesit ndërkombëtarë përkthyen gjatë seansave gjyqësore si dhe të gjitha dokumentet e gjykatës që kishin të bënin me gjykimin nga anglishtja në shqip dhe anasjelltas, në bazë të nevojës.

C. Përmbledhje e provave

Gjatë shqyrtimit kryesor, trupi gjykues nuk ka dëgjuar asnjë dëshmitar, meqenëse asnjë nuk ishte propozuar nga ana e prokurorit publik ose mbrojtja. Prokurori publik iu referua provave të prokurorisë të paraqitura në gjykatë gjatë gjyqimit të parë të pandehurve.

Pasi shqyrtoi dosjen e çështjes dhe dëshmitë e mëparshme të paraqitura gjatë gjyqimit të parë kryesor, trupi gjykues konkludoi se më 10 maj 2001, tre të pandehurit Arsim Gashi, Mirsat Ibrahim dhe Halim Krasniqi ishin pjesë e një grupi të organizuar që ra në kontakt me shoferin e një kamioni MAN, me numër regjistrimi 816 M 690, me rimorkio me numër regjistrimi 719 M 226, në një zonë parkimi përballë Doganës në Pejë. Kjo vjen nga vëzhgimet e bëra nga oficerët italiane karabinierëve, në veçanti nga Mario Schiariti, i cili ishte thirrur si dëshmitar gjatë shqyrtimit kryesor të parë në vitin 2002. Karabinierët dyshonin se automjeti në fjalë po përdorej për transportim të paligjshëm të armëve pikën kufitare kaluese në Kullë dhe për këtë arsye veçanërisht po i monitoronin të gjithë kamionët që kalonin nëpër doganën në Pejë.

Pas kësaj, Arsim Gashi dhe Mirsat Ibrahim janë vërejtur duke udhëtuar në një automjet BMW 325, me numër regjistrimi 124 KS 552, përpara kamionit kurse Halim Krasniqi së bashku me një tjetër individ drejtonin një automjet të zi Mercedes 250 me numër të regjistrimit 128 KS 533 prapa kamionit, si pjesë e një konvoji që po e shoqëronte kamionin në një banesë private në Pejë.

Ata janë ndjekur dhe arrestuar më pas nga karabinierët para një shtëpie private në Pejë. Gjatë kontrollit të kamionit, policët italian zbuluan një sasi të madhe të armëve të shënuara si vijon:

1. 52 raketa-hedhës anti tanke të prodhimit ish-jugosllav të kalibrit mod. 44 mm. "M-80" ;
2. 20 cilindra kartoni të zi që përmbanin bomba mortaje të prodhimit ish-jugosllav të kal. mm 81/82 mod. "M-69" me siguresa të rregullueshme për veprim të menjëhershëm apo të vonuar;
3. 4 cilindra kartoni të zi që përmbanin bomba mortare të prodhimit ish-jugosllav të kal. mm 81/82 mod. "M-74" me siguresat rregullueshme për veprim të menjëhershëm apo të vonuar;

4. 1 cilindër kartoni të zi që përmbante bomba mortaje të prodhimit ish-jugosllav të kal. mm 81/82 mod me siguresa të rregullueshme në Bakelite për veprim të menjëhershëm pa numër serik;
5. 1 top i tipit ish-jugosllav pa predhë të zbrampsjes e kal. mm. 81/82 i modelit "M-61",
6. 10 cilindra kartoni të zi që përmbanin predha topi të prodhimit ish jugosllav mm. 82 mod. "M-60A";
7. 2 kutija të gjelbërta që përmbanin 1 raketë anti-tank që udhëhiqet me tel e modelit "AT-3 Sagger" secila pa konzole kontrolli;
8. 12 hedhësa raketa anti-tank të modelit "M-79" e kalibrit 90 mm. prej tyre numri i 10 i plotë, Numri 1 pa pajisje shkrepjeje dhe vështrimi dhe Numri 1 pa mbështetje për shpatull si dhe pa pajisje shkrepjeje dhe vështrimi;
9. 12 hedhëse raketash anti-tanke mod. "M-79" të kalibrit 90 mm;
10. 1 mortajë e modelit "M-57" e kalibrit 60 mm. pa pjatë mbështetjeje;
11. 1 pajisje për shikim për mortajën model "M-57" e kalibrit 60 mm;
12. 1 mortajë e modelit "M-69" e kalibrit 81/82 mm. pa dykëmbësh, e pajisur me shtupë për pastrim;
13. 1 top pa zbrapsje i modelit "M-60A" i kalibrit 82 mm. i hipur mbi një shtrat topi me rrota, me shtupë për pastrim dhe pa pajisje vështrimi;
14. 4 raketa anti-ajrore portative të modelit "SA-14" të kalibrit 7 mm, nga ato numri 1 me pajisje të shkrepjes;
15. 7 bateri të cilat mund të gjuhen për raketa anti-ajrore portative të modelit "SA-14" të kalibrit 75 mm. pa numër serik;
16. 1 pajisje shkrepjeje për raketa anti-ajrore portative të modelit "SA-14" të kalibrit 75 mm;
17. 1 raketë anti-ajrore portative e modelit "SA-16" e kalibrit 70 mm., pa pajisje shkrepjeje dhe bateri;
18. 2 mitraljoza të modelit Zastava "M-84" të kalibrit 7,62 mm;
19. 1 kuti e cila përmbante një rrip arme me 98 predha, për modelin Zastava "M-84" të kalibrit 7,62 mm;
20. 1 pushkë sulmi Zastava e modelit "M70-A" e kalibrit 7,63 x 39 mm;

21. 4 magazina për pushkë sulmi të modelit Zastava "M70-A" të kalibrit 7,63 x 3 mm;
22. 86 predha të ndryshme (predha gjurmëlënëse, plumba të zakonshëm dhe shtypës) për pushkë sulmi të modelit Zastava "M70-A" të kalibrit 7,63 x 39 mm;
23. 5 pushkë gjysëm automatike të modelit Zastava "M76-A" të kalibrit 7.9 mm.me pajisje vështrimi të saktë dhe magazina;
24. 20 predha të kalibrit 7,9 mm për pushkë gjysëm automatike "M76-A".

Gjykata konstaton se në çdo kohë kritike të pandehurit Arsim Gashi, Mirsat Ibrahimimi dhe Halim Krasniqi, në bashkëpunim, ishin në posedim të kësaj sasive të madhe të armëve.

Gjatë marrjes vendimit të vet, trupi gjykues shqyrtoi me kujdes provat e paraqitura në gjykimin e parë kryesor.

Ky gjykim kryesor është ri-gjykim. Ngjarjet që janë subjekt i këtyre procedimeve penale kanë ndodhur në maj 2001. Prokuroria u përball me vështirësi të dukshme në sjelljen e dëshmitarëve para gjykatës - duke përfshirë pjesëtarë të karabinierëve italianë të cilët që nga atëherë e kanë braktisur Kosovën - e të cilët kanë mundur të ndihmojnë gjykatës gjatë marrjes së vendimit lidhur me pretendimet që janë subjekt i aktakuzës së ndryshuar. Më tej, kalimin i kohës do të ketë pasur në mënyrë të pashmangshme efekt negativ mbi cilësinë e provave të dëshmive.

D. Përcaktimi i dënimit.

Kur u vendos për një dënim të përshtatshëm për të tre të pandehurit, trupi gjykues mori parasysh se secili nga të pandehurit në fillimin e shqyrtimit kryesor e kishte pranuar fajësinë, se 10 vjet kishin kaluar që nga kryerja e veprës penale dhe se të pandehurit janë tani pjesëtarë plotësisht të integruar të shoqërisë dy prej të cilëve janë të martuar, kanë fëmijë të cilët ata ende i mbajnë. Më tej, nuk ka dosje për ndonjë nga të pandehurit që kanë kryer ndonjë vepër të mëvonshme kriminale.

Prandaj, trupi gjykues vendosi të nxjerrë dënime me burgim prej 300 ditësh për Arsim Gashi, 223 ditë për Mirsat Ibrahimimi dhe 185 ditë për Halim Krasniqi. Koha e kaluar tashmë në paraburgim do të llogaritet në dënim, sipas nenit 50 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe të nenit 351 të Ligjit të Procedurës Penale.

E. Shpenzimet

Edhe pse të pandehurit ishin shpallur fajtor nga trupi gjykues, gjykata nuk do të lëshojë vendim për shpenzimet për shkak të faktit se ky rast ka përfunduar shpejt dhe me efikasitet si rezultat i pranimit të fajit heret nga të pandehurit.

Më 11 nëntor 2010.

Gjyqtari Malcolm Simmons
Gjyqtar kryesues

Gjyqtari Riku Jaakkola
anëtar i trupit gjykues

Gjyqtari Shaban Shala
anëtar i trupit gjykues

Robina Struthers
Procesverbal mbajtëse

Këshillë juridike: Personat e autorizuar mund të parashetrojnë ankesë kundër aktgjykimit të lëshuar shkallë të parë brenda 15 ditëve kur transkripti i aktgjykimit të jetë i dorëzuar sipas nenit 359 të Ligjit të Procedurës penale.